



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:298240

Datë: 20.03.2024

Numri i dokumentit: 05481168

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr../..

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, me gjyqtarin e vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale kundër të pandehurit A..B.. për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme PP/II.nr.2569/23, të datës 26.12.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestarë me datë 26.02.2024 në prezencë të Prokurorit të Shtetit Ardiana Veseli, të pandehurit A..B.. të njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me datë 20.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

A..B.. i biri i R.. dhe nënës I.. e vajzërisë D.., i lindur me 26.11.2000 në Pejë, tani me banim në rr. "H.. H.." fsh. V.. r.. .. K. P.., me profesion murator, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr....., i lëshuar nga MPB Republika e Kosovës, posedon nr. të telefonit, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar me parë, **mbrohet në liri.**

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me dt. 13.12.2023, rreth orës 00:50 në rr. "H.. M.." në fsh.V.. K.P.., pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope ose analoge me sasi prej 0.7 gram, në atë mënyrë që gjersa zyrtaret policor ishin duke patrulluar në rrugën e lartcekur kanë ndaluar veturën BMË me targa që drejtonte i pandehuri A.. dhe në derën e pasagjerit kanë hasur një grinder (mulli për bluarjen e substancës narkotike) dhe gjatë bastisjes në gjepin e djathtë të xhaketës i gjejnë dhe i konfiskojnë një folje cellofoni me substancë narkotike, ashtu që pas kryerjes së analizës së narkotikut ka rezultuar se substanca e llojit Marihuanë me peshë neto prej 0.7 gram.

-me çka ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata duke u bazuar në nenin 4, 7, 17, 69, 70, 81, 82 dhe 269 par. 2 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurit i shqipton:

VËREJTJE GJYQËSORE

Me të cilin te pandehurit A..B.. i bëhet me dije se ka kryer një veprë të dëmshme dhe të rrezikshme që përbën veprë penale dhe nëse kryen prapë veprë të tillë, gjykata do t'i shqiptoi sanksion më të rëndë penal.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € (njëzetë) euro dhe në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 (njëzetë)) euro në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të marrë formën e prerë.

Arsyetim.

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP/II.nr.2569/23, të datës 26.12.2023, kundër të pandehurit A..B.. për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së.

Ne shqyrtimin fillestarë të datë 26.02.2024 gjykata e ka udhëzuar te pandehurin për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaroi për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmin, as të pranojë fajësinë, të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij.

Pas leximit të aktakuzës, gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën. Me pas gjykata e ka njoftuar te pandehurin për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë dhe e ka njoftuar se me Kodin Penal të Kosovës, pranimi i fajësisë është paraparë si njëra prej rrethanave lehtësuese me rastin e caktimit dhe lartësisë së dënimit. Ky është favorimi mirëpo me pranimin e fajësisë nuk do të ketë procedurë të provave ku ju do të keni mundësi të kundërshtoni provat e aktakuzës dhe njëkohësisht të merrni prova në mbrojtjen e juaj. Përfundimisht aktgjykimi në bazë të pranimit të fajësisë nuk mund të ankimohej për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

I pandehuri është deklaruar e pranoj fajësinë për veprë penale sipas aktakuzës, jam penduar dhe shton se është e vërtetë që e kam kryer këtë veprë dhe premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprimet të këtilla.

Ne vlerësimin e pranimin të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e Prokurorit të Shtetit i cili ka deklaruar se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, i njëjti pranim është bere ne mënyrë vullnetare nga i pandehuri dhe po ashtu gjen mbështetje ne shkresat e lëndës.

Gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se ne seancën e shqyrtimit fillestarë nuk ekzistojnë rrethana për hedhjen e aktakuzës nga neni 248 par. 1 pika 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPPRK-se dhe 322 të KPPRK-së, Raporti i oficerit I. Z. KPS-11419 i dt.13.12.2023, Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i DHTN në Pejë i dt. 13.12.2023, Raportit i analizës se narkotikeve i DHTN-së i dt. 13.12.2023, Procesverbali i marrjes në pyetje i të dyshuarit A..B.. e dhënë në stacion policor në Pejë me dt. 13.12.2023, Procesverbali i marrjes në pyetje i të dëshmitarit A.. K.. e dhënë në stacion policor në Pejë me dt. 13.12.2023, Foto dokumentacioni i shkresave të lëndës, andaj ka marr aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri e me pas me shqiptimin e dënimit.

Andaj me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i cili mbështet në provat në baze të cilave bazohet aktakuza është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale nga neni 269 par. 2 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 par.1, 2 dhe 3 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurën, gjykata mori pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurit faktin se me par nuk ka qen i dënuar, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata nuk gjeti.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vlerësuar se me vërejtjen e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e njëjta është e mjaftueshme për të arritur qëllimin e dënimit nga neni 38 i KPRK i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në nenin 449 të KPPRK-së, e obligoi të akuzuarin që ti paguaj shpenzimet e e paushallit gjyqësor në shumë prej 20€, e duke u bazuar ne shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj, dhe 20,00 € për taksen për programin për kompensimin e viktimave të krimit.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364, nenit 498 dhe 499 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa komfor nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
2023:298240, 20.03.2024**

Bashkëpunëtorja Profesionale

Edona Berisha Kastrati

Gj y q t a r i

Musë Povataj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.